



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DIMAL**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Procesverbal**

**Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Dimal**

**Mbajtur më datë 14.10.2024**

Ora e hapjes së mbledhjes 14:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes në Njësinë Administrative Poshnje kati i I-rë salla e mbledhjeve e Këshillit të Bashkisë Dimal. Mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Dimal e hapur.

Listë prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. Anila Shahini
2. Adelina Vangjeli
3. Avdulla Salillari
4. Bajame Mjelli
5. Bukuroshe Goga
6. Gerta Kumaraku
7. Hysen Hoxha
8. Julian Kora
9. Kozeta Protoduari
10. Lorenc Plaku
11. Luto Goga
12. Petref Sula
13. Saljon Hoxha
14. Shkelqim Tafa

14 Këshilltare prezent ne mbledhje.

Në mbledhje janë të pranishëm përfaqësues të administratës të cilët kanë hartuar projekt vendimet që do të merren në shqyrtim.

Kryetari i Këshillit deklaroj hapjen e mbledhjes.

Mbi miratimin e rendit të ditës.

Kryetari i Grupit Z. Shkëlqim Tafa kërkon fjalën.

A.Salillari: I jep të drejtën e fjalës.

Sh.Tafa: Lexon një kërkesë e cila ka të bëjë me vijëmesinë e punës së Këshillit Bashkiak Dimal. Kjo kërkesë e tij drejtuar Kryetarit të Këshillit Bashkiak dhe Sekretarit të Këshillit. E lexon kërkesën e cila përbëhet nga 3 faqe, e cila është dhe e firmosur prej tij.

**Pika 1 e rendit të ditës dhe Pika 2 e rendit të ditës** është mbledhur Komisioni i Ekonomisë dhe Financës ditën e hënë datë 07.10.2024. Mbi miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për 3 familje me fond 19.741 lekë për muajin Gusht 2024, dhe mbi miratimin e projekt-vendimit trajtimin me ndihmë ekonomike sipas listës emërore bashkëlidhur për 108 familje nga fondi i bashkisë në shumën 304.000 lekë për muajin Gusht 2024.

Hidhen në votim dhe miratohen me 4 vota pro nga 4 Këshilltarë prezentë të Komisionit Ekonomik Financë: 1. Lorenc Plaku, 2. Petref Sula, 3. Bajame Mjelli, 4.Shkëlqim Tafa.

**Pika 3 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : Mbi miratimin Shtesë buxheti Viti 2024.

M.Bizdani: Materiali i dërguar për shtesën e buxhetit ka të bëjë me shtesën e buxhetit në fushën e arsimit rritja e pagave mbi bazen e vendimit të Këshillit të Ministrave fillon nga 1 Korriku 2024, dhe për përballimin e diferencës së pagës nga ajo që ishte dhe asaj të re, qeveria ka akorduar fondin 6.394.102 lekë, dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi i është dërguar fondi 1.409.639 lekë, ky fond i destinuar për sigurimet shoqërore. Gjithashtu në këtë material kemi dhe shtesën e buxhetit që është bërë nga shoqëria Trans, e cila ka bërë sponsorizimin me destinacion përdorimi shpenzime për përmisimin e kullotave në Bashkinë Dimal, mbështetur në kontratën e nënshkruar midis Bashkisë Dimal dhe shoqërisë Trans.

H.Hoxha: Pika 1 dhe 2 nuk ka ndonjë gjë sepse është vendimi i qeverisë, për pikën 3 një shpjegim më shumë.

M.Bizdani: Po, kjo masë do të përdoret me këtë destinacion përmisimin e kullotave në Bashkinë Dimal për këtë është hartuar projekti nga zyra përkatëse.

Sh.Tafa: Në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë është kërkuar a ka një projekt të kullotave?

M.Bizdani: materiali është përgatitur nga zyra përkatëse sepse donatori nuk e nëshkronte kontratën pa lëshuar materialin e këtij donacioni.

Sh.Tafa: A ka projekt?

M.Bizdani: Po ka.

Sh.Vrapi Nënkyetar: Në kushtet e donatorit pa siguruar bindjen nuk bën celje.

H.Hoxha: E mira ishte të na ishte sjellë projekti.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro nga 14 këshilltarë prezentë.

**Pika 4 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : Për miratimin e një fondi të menjëhershëm për personat që janë me dializë në Bashkinë Dimal dhe familje në nevojë.

R.Hoxha: Duke u bazuar dhe në kërkesat e ardhur nga antarë të Këshillit Bashkiak për personat me dializë për lehtësimin e një pjese të transportit që ata bëjnë për të marrë shërbimin e domosdoshëm për shëndetin e tyre. Do të trajtohen dy familje me dializë që janë 1. Agim Rexhep Xhelo i cili jeton në fshatin Banaj, Njësia Administrative Poshnje dhe 2. Miltiadh Naun Naco i cili jeton në Poshnje, Njësia Administrative Poshnje secili në vlerën 20.000 lekë.

Gjithashtu do të trajtohen me fond emergjent edhe dy familje 1. Nertil Kamenica banor në fshatin Hingë, familja e tij përbëhet nga 4 persona dhe në kushte të vështira ekonomike, 2. Novrus Vrapi i cili jeton në Pashalli, pensionistë në kushte të vështira ekonomike.

A.Salillari: A ka ndonjë pyetje?

Asnjë prej këshilltarëve nuk ka pyetje.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro nga 14 Këshilltarë prezentë.

**Pika 5 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : Për miratimin e hapjes për 4 pozicione të reja pune në Sektorin e Qendrës Komunitare Multifunkionale, Bashkia Dimal.

R.Hoxha: Kjo shtesë ka ardhur si nevojë e Sektorit Arsim Kulturës, duke qënë se jemi në fazat e para duhet të sistemojmë këto problematika, 1.Edukatore në kopshtin qendër e cila është parë e nevojshme nga numri i lartë i kërkesave për regjistrimin e fëmijëve në Kopshtin me drekë. Gjithashtu na duhet një sanitare, teknik i mesëm dhe një elektrikist. Paga për këto 4 pozicionet është me fond specifik nga buxheti i arsimit. Ndërsa dy vendet e tjera janë për Qendrën Multifunkionale sepse kemi patur një rast në fshatin Hingë, të një zonje “tetraplegjikë”, duke qënë se kjo është një kompetencë e pushtetit vendor për të siguruar kujdestarë me kohë të plotë në shërbim të tyre. Kjo zonjë për fat të keq humbi jetën në spitalin e Beratit. Paga për dy pozicionet si kujdestarë në varësi të Qendrës Komunitare Multifunkionale do të jenë me fond nga Buxheti i Bashkisë.

A.Salillari : A ka ndonjë pyetje, diskutim?

Asnjë prej këshilltarëve nuk ka pyetje.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro nga 14 Këshilltrë Prezentë.

**Mbi miratimin e projekt-vendimit :** “Për miratimin për shtesë aktivitetesh tek Aktiviteti 3.1.1 “Zgjerim i shërbimeve të Qendrës Multifunkionale të Bashkisë i parashikuar në Planin Social 2024-2026 i miratuar në KB me Nr. 48 datë 26.12.2023”.

R.Hoxha: Mbështetur në Planin Social të Bashkisë Dimal miratuar në Këshillin Bashkiak me Nr. 48 datë 26.12.2023 në të cilin kemi përcaktuar Qëllimin Strategjik, Diversifikimi i shërbimeve sociale ekzistuese për t’iu përgjigjur efektivisht nevojave të individëve në situatë vulnerabël në territorin e bashkisë përkatësisht tek : Objekti Specifik 1. Shërbimet Sociale komunitare mundësojnë adresimin efektiv të rasteve emergjente si dhe rintegrimimin , përkujdesjen mbrojtjen e fuqizimin e individëve që i kanë të nevojshme këto shërbime.

Nëse dalim fitues nga ministria paga do të jetë specifike, për këto persona që do të punësohen për këtë kategori të personave paratetraplegjik, të cilët nuk kanë familjar dhe e kanë të pamundur të kujdesen për veten.

A. Salillari : A ka ndonjë pyetje?

Nuk ka asnjë pyetje nga Këshilltarët, janë dakort, hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro nga 14 Këshilltarë prezentë.

**Pika 6 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : “Për miratimin e vlerës së qirasë së ambienteve private të cilat do të funksionojnë si kopësht/shkollë për t’u përdorur për nevoja të Bashkisë Dimal.

B.Hoxha: Sektori i Arsimit ka paraqitur materialin për miratimin e vlerës së qerasë për 3 ambientet të cilat do të funksionojnë si kopësht/shkollë. Për ambientin e marrë me qera në Donofrosë, e cila është e dëmtuar nga tërmeti dhe kemi marrë ambient me qera , në pronësi të subjektit qiradhënës Ymerli Dushku. Edhe në fshatin Polizhan kemi marrë me qera ambientin për arsimin parashkollor në pronësi të subjektit qiradhënës Ardit Cobo, si dhe për arsimin parashkollor kemi marrë me qira ambientin në pronësi të subjektit Përparim Minaj.

Tek kopshti rërëz që e kishim ambient me qera janë sistemuar në godinën e shkollës.

S.Hoxha: Nuk kemi diskutim janë të qarta.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro nga 14 këshilltarë prezentë.

**Pika 7 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : Mbi miratimin e dhënies së titullit të lartë vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal.

B.Hoxha Si propozim për qyetar nderi na kanë ardhur 4 figura 1) Sotiraq vasil Boro ka qënë mësues , 2) Luftar Brahim Shehu fatkeqësisht ndërroi jetë ditën e premtë dhe duhet të bejmë një korigjim tek motivacioni të cilin duhet ta bëjmë pas vdekjes, 3) Bukurie Osman Tafa dhe 4) Haxhi Diko Oshafi pas vdekjes me motivacionin për kontributin e dhënë si kryetar i shoqatës të vaditjes duke i ardhur në ndihmë fermerëve të zonës së Kutallisë, Poshnjës, Cukalatit për përmisimin e vaditjes dhe lehtësimin e vaditjes së të mbjellave në sera dhe fusha.

Sh.Tafa: Kisha një propozim, meqënëse profesori Luftar Brahim Shehu ka ndërruar jetë propozoj 1 minutë heshtje për njeriun e punës.

A.Salillari: Meqënëse Z.Shkëlqim dha një propozim le ta respektojmë.

A.Salillari: Kemi ndonjë pyetje tjetër?

Asnjë nga Këshilltarët nuk ka pyetje.

Në këtë pikë të rendit të ditës, largohet anëtari Z. Sh.Tafa.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro nga 13 Këshilltarë prezentë.

**Pika 8 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : “ Për emërtimin e disa rrugëve në Bashkinë Dimal.

B.Hoxha: Me propozimet që kanë ardhur për emërtimet e rrugëve janë:

1- Rruga “Veiz Hajdar Plaku” në lagjen 18-Tetori , Njësia Administrative Ura Vajgurore.

2- Rruga “Lazar Ndini Fype” në fshatin Konezbaltë si dhe 3- Rruga “Islam Hysen Kapllani” në fshatin Pashalli, një kërkesë e ardhur dhe nga banorët për kontributin e dhënë si partizan i Brigadës 8-sulmuese ku është dalluar si një partizan trim dhe i guximshëm.

K.Protoduari: Të gjithë ne jemi në dijeni që janë vendosur disa tabela, në lagjen e Protoduarëve, emri i lagjes të ndryshohet pasi nuk është shkruar siç duhet Protoduar, unë propozoj edhe si kërkesë të banorëve të lagjes, të vendoset emri Murat Protoduari.

A.Shahini: Është bërë një kërkesë nga komuniteti i Cukalatit, janë dy emërtime Arifaj, banorët e Cukalatit kërkojnë që emri i rrugës në Cukalat të jetë Hoxhë Luto Zanaj i cili ka dhënë një kontribut në luftën nacional çlirimtare. Në këtë pikë të rendit të ditës rikthehet antari Z.Shkëlqim Tafa.

A.Salillari : A ka ndonjë kërkesë tjetër?

Jo nuk ka, hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro nga 14 Këshilltarë prezentë.

**Pika 9 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : Mbi miratimin e projekt-vendimit: Marrëveshja e bashkëpunimit me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore në funksion të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje”.

G.Bolani: Kemi hartuar një marrëveshje e cila ka ardhur si marrëveshje tip me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës. Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimet dhe kordinimit ndërmjet Bashkisë dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, në kuadër të zbatimit të lëgjislativitetit në fuqi. Bashkia dhe ASHK-ja do të bashkëpunojë duke përgatitur dosjet dhe duke bërë matjet faktike, Ky proces prek të gjitha objektet që janë në proces legalizimi.

A.Salillari: Nga cili vit do të merren në konsideratë?

G.Bolani: Pas vitit 2020 nuk klasifikohen, bëhet fjalë për objektet që janë futur në proces legalizimi. Procesi është i hapur duhet bërë vetëm aplikimi. Aplikimi bëhet në ASHK, dhe në Bashki paraqitet në momentin kur ti ke aplikuar, edhe kur kërkohen dokumentacione që mungojnë në dosje.

H.Hoxha: A do të ketë një grafik si do të thirren si do të njoftohen qytetarët?

G.Bolani: Ne kemi bërë njoftimet si Bashki më prioritare vendosim zonën më problematike dhe ne kemi bërë një grafik.

H.Hoxha: Si do të lajmërohen qytetarët?

G.Bolani: Qytetarët lajmërohen nga ne, sepse hipoteka ka sjellë listën emërore, ndjekim praktikën duke plotësuar dokumentacionin përkatës.

A.Salillari: A ka nisur kjo punë nga ana juaj?

G.Bolani: Po ka nisur është ngritur një urdhër, aktualisht kemi filluar në zonën e Drenovicës.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 14 Vota pro nga 14 Këshilltarë Prezentë.

**Pika 10 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e projekt-vendimit : Për disa shtesa në VKB nr 40 datë 22.11.2023 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të paketës fiskale Nr.72 datë 21.11.2022” të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe miratimin e projektit tip të banesave një familjare.

G.Bolani: Referuar VKM-së përkatëse Nr.377 datë 12.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr 408 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave ka hartuar një relacion ku e ka qartësuar kategorizimin e banesave, ku banesat tip e ndihmon zonat rurale në lehtësimin e procedurave për të aplikuar për leje ndërtimi. Projekti tip iu është dërguar edhe si

material i hartuar që do të thotë që procedura është më e lehtësuar për një qytetar që aplikon për këtë projekt, dhe nuk është e nevojshme të shpenzoj për sa i përket hartimit të projektit, gjithashtu i është përjashtuar tarifa e shërbimeve nga ana e Bashkisë, janë zeruar të gjitha duke filluar nga leja e zhvillimit, leja e ndërtimit, njoftimit i fillimit të punimeve. Ky projekt konsiston në lehtësimin e procedurave të lejes së ndërtimit vetëm për zonat rurale, ndërsa për zonat e qytetit nuk bën pjesë. Kemi paraqitur dy variante 1+1 dhe 2+1 varet se kë zgjedh qytetari.

Sh.Tafa: E shikoj si një material të plotë dhe shpjegues.

H.Hoxha: Po, ky ishte dhe mendimi i Komisionit Ekonomik, një material i plotë dhe shpjegues.

A.Salillari: Hidhet në votim, miratohet me 14 Vota pro nga 14 Këshilltarë prezentë.

Mbi miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësie të Vetëqeverisjes Vendore sipas VKM-së Nr.503 datë 1.8.2024.

M.Bizdani: Materiali i cili iu është dërguar ka të bëjë me ndryshimin e pagave të administratës vendore. Në ndryshim nga Administrata qendrore, Administrata Vendore rritja e pagave për pushtetin vendor fillon nga data 1.09.2024.

Me VKM-në Nr.503 datë 01.08.2024 për disa ndryshime në VKM-në Nr.328 datë 31.05.2023 “ Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Qeveria na ka dërguar dhe shtesën e fondit i përballon këto rritje të pagave, nisur nga pogramet buxhetore që ne kemi në bashki që kemi rreth 12 pogramet, fondit i ardhur është ndarë në disa pgramet buxhetore. Ne ju kemi dërguar edhe tabelën me pagën e cdo pozicioni pune për administratën, dhe të zgjedhurit që janë kryetar, nënkryetar, dhe administrator sepse VKM nr 503 datë 1.8.2024 e ka pozicionin e pagës me një kufi nga minimal deri në maksimal. Ne në materialin e paraqitur, kemi zbatuar nivelin mesatar të pagave.

H.Hoxha: Ka një propozim nga Komisioni për ndryshimin e masës së këshilltarëve të jetë 10%.

M.Bizdani: Po lidhur me këtë propozim e bëm dhe ndryshim dhe e kemi shpërndarë këtë ndryshim dhe j’ua kemi shpërndarë tabelën me këtë ndryshim.

Sh.Tafa: Në komision është sugjeruar që të shikohet niveli i pagës për sekretarin e përgjithshëm.

Sh.Vrapi: Bashkia ka një titullar dhe performancën e tërë punonjësve e di titullari dhe ka të drejtë të vendos nga minimumi deri në maksimum. Nuk ka të drejtë asnjë të ndërhyj në performancën e gjithsecilit nga punonjësit që ka Bashkia.

Sh.Tafa : Kjo rritje do të përballohet nga buxheti i Bashkisë?

M.Bizdani: Këto janë me buxhetin e vitit 2024 plus shtesën që solli qeveria tani.

A.Salillari: Hidhet në votim miratohet nga 13 vota pro dhe 1 votë kundër nga 14 këshilltarë prezentë.

**Të ndryshme:**

S.Hoxha: Kam një shqetësim lidhur me pastrimin ne kemi një grafik e kemi miratuar dhe në Këshill, për zonën e Drenovicës është shumë problem pastrimi.

A.Salillari: 3 rrugët në hyrje të qytetit, këto janë problematika sepse makinat ikin me shpejtësi dhe të shikohet mundësia për tu bërë dicka të vendoset ndonjë pengesë.

Sh.Tafa: Hapja e procedurave të zgjedhjes së Kryeplakut të Fshatit Pobrat.

Gjithashtu tek rruga e re sygjeroj edhe për polica të shtrirë, dhe objekti i cili nuk është prishur akoma për të cilin kemi marrë vendim.

G.Bolani: Përsa i përket sinjalistikës për polica të shtrirë rruga është akoma në vazhdim nëse nuk plotësohen të gjitha zërat sipas preventivit nuk do të merret në dorëzim.

Për sa i përket objektit, vazhdimisht kemi kontaktuar me Agjensinë e shpronësimit dhe kemi bërë kërkesën e saj dhe presim të dali njoftim.

Sh.Tafa: Të shihet mundësia për vendosjen e koshave akoma dhe më shumë.

Si dhe dy propozimet e ngritura nga antarët e Këshillit për emërtimin e rrugëve 1) Kozeta Protoduari, për emërtimin e rrugës Murat Protoduari dhe 2) Anila Shahini për emërtimin e rrugës së Cukalatit me emrin Hoxhë Luto Zanaj.